

Sheqirin e varrosën në varrezat në lagjen *Krasniqi*, në Gllanasellë/Gladno Selo.

Burimi: deklarata R.K, FDH-17216.

Sefer (Rexhep) Tafaleci

(28.05.1937, shqiptar nga Vrboci/Vrbovac, komuna e Glllogocit/Glogovac, bujk, pesë fëmijë)

Kur forcat serbe e sulmuan **Vrbocin/Vrbovac** më **22.09.1998**, familja e Seferit e braktisi fshatin dhe u strehua në vendin e quajtur *Fusha e Mollës/Jabukovo polje*, ndërsa ai shkoi në pyllin e fshatit fqinj të Shtuticës/Štutica. Dy ditë më vonë, kur situata u qetësua, familjarët u kthyen në shtëpi por nuk e gjetën Seferin atje. Po atë ditë, një vendas, Smajl Prokshi, u ka treguar familjarëve që policët serbë e kanë vranë Seferin në *Mëhallën Tafaleci* më 22.09.1998, pasi që ai u kthye nga pylli. Nga mëhalla e tij, Smajli kishte vërejtur kur dy policë dolën nga një makinë zyrtare dhe shtënë mbi një person, për të cilin ai, kur policia u largua nga fshati, konstatoi se bëhej fjalë për Sefer Tafalecin. Një ditë më vonë, Smajli e ka varrosur Seferin në fushën ku edhe e kishin vranë. Në datën 27.09.1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Seferit në varrezat e *Mëhallës Gllarevës/Glarevo* në Vrboc/Vrbovac Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Seferit janë rivarrosur në varrezat e fshatit të Vrbocit/Vrbovac më 9.09.1999.

Burimi: deklarata S.T, FDH-14900.

Nazif (Hysen) Neziri

(5.11.949, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Glllogocit/Glogovac, mekanik, gjashtë fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar Likoshanin/Likošane më 22.09.1998, gjë që i detyroi banorët që ta braktisnin fshatin dhe të strehoheshin në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*, përmbi fshatin e **Gradicës/Gradica**. Nazifi me familje qëndronte në një luginë. Ditën e nesërme, më **23.09.1998**, familja e tij dhe refugjatë të tjerë në këtë lokacion iu nënshtruan zjarrit të rëndë nga artileria serbe. Një predhë ka rënë shumë afër Nazifit dhe familjarëve të

tij. Nga shpërthimi i saj, Nazifi u plagos në ballë, ndërsa bashkëshortja e tij Sherifja në fytyrë. U plagosën, gjithashtu, vajza Behija, e reja Lumnija dhe mbesa njëvjeçare Diana. Një ditë më vonë, policët serbë e kanë çuar Nazifin dhe Behijen në spitalin e Prishtinës/Priština, ku ai iu nënshtrua intervenimit kirurgjikal. Dy muaj më vonë, e liruan nga spitali në gjendje shumë të rëndë. Kaloi me familjen në Maqedoni më 5.05.1999, ku menjëherë e vendosën në spital. Për atë kujdeseshin mjekët norvegjez. Në Kosovë u kthye në muajin qershor të vitit 1999. Për shkak të gjendjes së rëndë menjëherë u shtri në spital në Prishtinë/Priština. Në datën 21.08.1999, Nazifi ka dhënë shpirt. Po atë ditë, atë e varrosën në varrezat e fshatit të tij të lindjes.

Burimi: deklarata S.N, FDH-18005.

Skender (Emin) Bardiqi

(18.05.1953, shqiptar nga Gradica, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor, tetë fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar Gradicën/Gradica më 23.09.1998. Banorët u detyruan ta braktisnin fshatin dhe të strehoheshin në pyjet. Kur të shtëna pushuan më **23.09.1998**, diku nga ora 15:00, Skënderi vendosi të shkonte dhe ta kontrollonte shtëpinë e vet dhe të shihte nëse çdo gjë ishte në rregull. Afro 10 minuta më vonë, vëllai i Skënderit ka dëgjuar të shtëna që vinin nga drejtimi i *Mëhallës Bardiqi*, ku gjendej shtëpia e Skënderit. Por, ai nuk guxoi të shkonte atje të shihte çfarë kishte ndodhur. Të nesërmen, kur forcat serbe u tërhoqën nga fshati, familjarët e kanë gjetur trupin e pajetë të Skënderit afro 100 metra larg shtëpisë [**Gradicë/Gradica**]. Në gjoks dhe në kokë i kishte plagët nga plumbat. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Skënderin në varrezat e *Mëhallës Bardiqi*.

Burimet: deklarata N.B, FDH-18002; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, tetor-dhjetor 1998, 117, FDH-8150.

Xhevat (Sheqir) Berisha

(11.02.1959, shqiptar nga Gllanasella/Gladno Selo, komuna e Glllogocit/Glogovac, bujk, pesë fëmijë)